

VENDIM
Nr. 416, datë 7.7.2023

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR
PËRFITIMIN E LEHTËSIRAVE FISKALE NGA ZHVILLUESIT DHE
PËRDORUESIT QË OPEROJNË NË PARQET TEKNOLOGJIKE DHE SHKENCORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KRITERET PËR PËRFITIMIN E LEHTËSIRAVE FISKALE

1. Zhvilluesi, që të përfitojë lehtësirat fiskale, duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

a) të ketë lidhur kontratë me institucionin përgjegjës për ndërtimin dhe administrimin e parkut, ku janë pasqyruar lehtësirat fiskale;

b) të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si zhvillues i parkut teknologjik dhe shkencor;

c) të përmbushë detyrimet që lindin nga kontrata e lidhur me institucionin përgjegjës;

ç) të jetë pajisur me autorizimin përkatës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për administrimin e zonës, si zhvillues, në përputhje me Kodin Doganor.

2. Përdoruesi, që të përfitojë lehtësirat fiskale, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë lidhur kontratë qiraje me zhvilluesin për fillimin e aktivitetit në park, ku janë pasqyruar lehtësirat fiskale;

b) të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për kryerjen e aktivitetit, si përdorues i parkut teknologjik dhe shkencor;

c) të ketë realizuar detyrimet që lindin nga kontrata e lidhur me zhvilluesin.

II. RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR PËRFITIMIN E LEHTËSIRAVE FISKALE NGA ZHVILLUESI

1. Institucioni përgjegjës njofton institucionet qendrore dhe lokale për miratimin e parkut dhe zhvilluesit, me qëllim përfitimin e lehtësirave fiskale.

2. Lehtësirat fiskale për zhvilluesin fillojnë me fillimin e veprimtarisë ekonomike në park.

3. Data e fillimit të punimeve konsiderohet data e fillimit të veprimtarisë ekonomike në park, pas pajisjes me lejet, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Zhvilluesi, në mjediset ku ushtron veprimtarinë ekonomike, krijon aksesin e nevojshëm për nëpunësit e administratës tatimore dhe vë në dispozicion të saj librat, regjistrimet, informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

5. Zhvilluesi duhet të mbajë regjistrat dhe dokumentacionin kontabël, që përmbajnë informacionin e regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të veprimeve ekonomike, të përcaktuar në legjislacionin tatimor.

6. Përfitimi i lehtësirave tatimore, sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, nuk e përjashton zhvilluesin nga dorëzimi i deklaratës tatimore, sipas parashikimeve të legjislacionit përkatës në fuqi.

7. Sipërmarrësit, që ofrojnë dhe kryejnë shërbime ndërtimi, montimi dhe punë të ngjashme, për llogari të “zhvilluesit” në parkun teknologjik dhe shkencor, nuk përfitojnë lehtësirat fiskale për veprimtarinë që kryejnë në parkun teknologjik dhe shkencor.

8. Përfiton, sipas parashikimeve të shkronjës “ç”, të nenit 12, të ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, stafi i zhvilluesit që ka lidhur kontratë pune, sipas dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

III. RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR PËRFITIMIN E LEHTËSIRAVE FISKALE NGA PËRDORUESI

1. Përdoruesi përfiton lehtësirat fiskale vetëm pasi zhvilluesi ka njoftuar institucionin përgjegjës, institucionet e tjera qendrore dhe lokale për fillimin e aktivitetit të përdoruesit.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunimin me zhvilluesin krijon strukturën përkatëse me personel doganor për kryerjen e formaliteteve doganore dhe administrative në park.

3. Llogaritja dhe përjashtimi nga tatimi mbi fitimin për përdoruesit e parkut teknologjik dhe shkencor fillon nga data kur zhvilluesi lidh kontratë me përdoruesin.

4. Përdoruesi, që ushtron veprimtari ekonomike sipas kontratës së qirasë të lidhur me zhvilluesin, brenda territorit të parkut teknologjik dhe shkencor, dhe selia e regjistruar e të cilit është në park, do të përfitojë lehtësira fiskale sipas parashikimeve të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit.

5. Përfitimi i lehtësirave tatimore sipas pikës 4, të këtij kreu, nuk e përjashton përdoruesin nga dorëzimi i deklaratës tatimore, sipas parashikimeve të legjislacionit përkatës në fuqi.

6. Sipërmarrësit, që ofrojnë dhe kryejnë shërbime ndërtimi, montimi dhe punë të ngjashme, për llogari të “përdoruesit” në parkun teknologjik dhe shkencor, nuk përfitojnë lehtësirat fiskale për veprimtarinë që kryejnë në parkun teknologjik dhe shkencor.

7. Përdoruesi duhet të mbajë regjistrat dhe dokumentacionin kontabël, që përmbajnë informacionin e regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të veprimeve ekonomike, të përcaktuar në legjislacionin tatimor.

8. Përfiton sipas parashikimeve të shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, stafi i përdoruesit që ka lidhur kontratë pune sipas dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

9. Mallrat, pajisjet dhe shërbimet në parqet teknologjike dhe shkencore, që nuk përdoren për nxjerrjen e “Produktit inovativ”, por janë për përdorim apo konsum përfundimtar, nuk trajtohen si të përjashtuara nga TVSH-ja. Për këto furnizime zbatohet shkalla tatimore e TVSH-së, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku